

Prof. dr. Musa KRAJA

## AKADEMIKU JASHAR REXHEPAGIQ ME NJË TJETËR VEPËR MADHORE

Një nga personalitetet më të shquara të mendimit pedagogjik shqiptar, i njohur në tërë hapësirën shqiptare dhe më gjerë, për veprimtarinë e tij me shumë vlera në fushën teorike dhe aplikative të edukimit, profesori i profesorëve të pedagogjisë dhe i një mase mësuesish, akademiku Jashar Rexhepagiq, pas 9 vjetësh, ka risjellë në duar të lexuesit një botim të ri, të plotësuar. “Sami Frashëri dhe Pedagogjia e Rilindjes Kombëtare”, botim i Akademisë së Shkencave të Kosovës, në serinë e botimeve të veçanta është një kryevepër.

Duke ndjekur me vëmendje studimet e bëra për periudhën e Rilindjes Kombëtare në të gjitha trevat shqiptare, hulumtuesi ynë serioz dhe kompetent ka shkuar më tej, duke iu rikthyer ideologut të Rilindjes sonë Kombëtare, me një hyrje që shpreh *“nevojën, aktualitetin dhe rëndësinë e studimit të problemit”*.

Sot e kemi mjaft të domosdoshme të evidentojmë vlerat tona kombëtare në fushën filozofike, pedagogjike e psikologjike, me të cilat përgatitemi të integrohemi në Europë, sidomos në etapën e tanishme të Kosovës, por edhe të mbarë viseve shqiptare, që brezat e rinj, sidomos ata që përgatiten në këtë fushë, të njihen me një nga etapat e historisë së mendimit e veprimit shqiptar, siç është ajo e Rilindjes Kombëtare dhe e Sami Frashërit, një nga personalitetet më të shquara të asaj kohe për gjithë mendimin shkencor shqiptar.

Që në strukturë të veprës, del qartë se çfarë objektivash filozofike dhe shkencore-pedagogjike ka përdorur autori. Ai fillon me formimin e pedagogjisë së Rilindjes, me funksionin pedagogjik të Lidhjes së Prizrenit dhe ndikimin e saj në pikëpamjet pedagogjike të rilindësve, në veçoritë thelbësore të pedagogjisë së Rilindjes, në ndikimin pedagogjik të Hasan Tahsinit te personaliteti i lartë i Sami Frashërit etj., duke vazhduar me bazat filozofike e sociale të

mësimeve pedagogjike të Samiut, me parimet pedagogjike të tij etj., duke bërë edhe përfundimet përkatëse.

Sami Frashëri, mendimtari i madh, njohës i thelluar i mendimit filozofik e pedagogjik të kohës, në Lindje e Perëndim, organizatori dhe ideologu i organizmave të Rilindjes sonë Kombëtare, themeloi, në një qendër të madhe si Stambolli, “Shoqërinë e Stambollit”, apo “Shoqërinë e të Shtypurit Shkronja Shqip”, 1879, e më vonë, në qendra të tjera, edhe shoqëri kombëtare, arsimore e letrare, në Bukuresht, Sofje, Itali etj., të cilat, me një platformë të qartë, botuan libra e krijuan organe shtypi, themeluan shkolla, të modeluara si bashkëkohore, pa të cilat nuk mund të bëhej përpara në zgjimin e ndërgjegjes kombëtare apo në ngjarjet e zhvillimet e mëdha deri në Pavarësi.

Akademiku Jashar Rexhepagiqi, duke u marrë mbi tridhjetë vjet me studime të kësaj periudhe, ka arritur të sjellë tashmë një monografi shumë dinjitoze mbi mendimin pedagogjik të Rilindjes sonë dhe të Sami Frashërit, si ideolog i saj. Duke shfrytëzuar burime të shumta arkivore dhe bibliotekare të Kosovës, Tiranës, Shkupit, Stambollit, e më gjerë, ai shkruan veprën solide e gjurmëlënëse “Zhvillimi i arsimit dhe i sistemit shkollor të kombësisë shqiptare në territorin e Jugosllavisë së sotme deri në vitin 1918”, të botuar në Prishtinë, më 1970, në atë kohë kur vetëm ta përmendje këtë fushë ishte herezi, sepse skedohej e ndiqej çdo intelektual shqiptar, duke u përballur me terrorin serb. Ai e përfundoi me sukses këtë veprë, e cila përmbante një fushë të gjerë burimesh arkivore e përgjithësuese, burime në të cilat nuk mund të depërtohej lehtë, madje me shumë sakrificë, çka e bëri vetëm Jashar Rexhepagiqi. Prandaj ne, studiuesit e fushës, i jemi shumë mirënjohës, sepse nuk mund të përfundohet asnjë veprë për traditën shqiptare të asaj periudhe në fushën e edukimit, pa iu referuar dhe pa u mbështetur në këtë veprë. Tani, edhe pas kaq vitesh, mund të themi përsëri se nuk bëhet dot studim për Rilindjen tonë Kombëtare, pa e parë me shumë kujdes veprën në fjalë të studiuesit tonë.

Optika e profesor Jasharit është e gjerë. Ajo kap personalitetet e mëdha filozofike të Iluminizmit, në perëndim e në lindje, të cilët, Sami Frashëri dhe mësuesi i tij, Hasan Tahsini, i kanë njohur mirë e thellësisht, duke bërë hapa përpara edhe në mendimin filozofik. Në qoftë se te Samiu kemi një veprë të veçantë e madhore në fushë

të filozofisë, studiuesi Shaban Çollaku, njohës i thelluar i gjuhës turke e studiues serioz, botoi me dinjitet "Mendimi iluminist i Sami Frashërit", Tiranë, 1986, vepër e mbështetur në krijimtarinë studimore të Sami Frashërit, duke vënë që në krye, në kopertinë, mendimin filozofik e iluminist të asaj filozofie që ngrihej në zhvillimin dhe progresin e shoqërisë me anë të studimeve, arsimit e dijes, me anë të ndriçimit të mendjes, siç e thotë etimologjikisht edhe vetë rryma në fjalë.

Specialisti i pedagogjisë, njohësi i rrymave filozofike të kohës, profesor Jashari, ndalet njëkohësisht në disa trajtime në njohjen e rilindësve tanë të mëdhenj, të pikëpamjeve të Emanuel Kantit, të Rusoit, Ogyst Kontit, Herbert Spenserit etj., pranë të cilëve qëndruan e punuan iluministë të mëdhenj, veçanërisht ata francezë, filozofë e pedagogë të tjerë të mëdhenj të nivelit botëror si Herbarti etj.

Nisur nga synimi kryesor i punimit, në vlerësimin e ideve pedagogjike të Samiut, autori u referohet 15 veprave kryesore të tij, duke filluar nga "Shqipëria ç'ka qenë, ç'është e ç'do të bëhet", Bukuresht, 1899; më pas me "Abetare e gjuhës shqip", Bukuresht, 1866, e të tjerat me radhë, duke nënvizuar, diku në mes rreshtash, edhe personalitetin e mësuesit të parë, në shenjë falënderimi, sipas porosisë së fesë islame se "ai mësues që ka mësuar abetaren, është Zoti yt". Në një kapitull të rëndësishëm, autori trajton gjerësisht "Ndikimi pedagogjik i Hasan Tahsinit", duke e shprehur që në titull ndikimin e mësuesit të vet. Në shtëpinë e tij, çdo pasdite, merrnin mësim të rregullta universitare pothuajse të gjithë udhëheqësit e Rilindjes Kombëtare që banonin në Stamboll, si: Sami Frashëri, Jani Vreto, Ismail Qemali, Pashko Vasa etj. Sipas Samiut "Hoxha Tahsini ishte një nga njerëzit më të mëdhenj, të cilët, rrallë e me vështirësi, i lindën shekujt". Autori sjell të dhëna që mësuesi i Sami Frashërit, Hoxha Tahsini, gjatë 16 viteve të qëndrimit në Paris, jo vetëm ishte thelluar në fizikë, kimi, gjeologji e astronomi, kishte studiuar veprat e iluministëve francezë, por ishte marrë edhe me pedagogji. "Filozofia e Tahsinit, mbi të cilën mbështeten mendimet e tij mbi edukatën, shkollën dhe arsimin, - shkruan autori, - është një fushë e veçantë për studime në të ardhmen."

Për pikëpamjet e tij filozofike shkroi filozofi Riza Teufik në revistën "Musavver Arnavud" (Shqiptari në ilustrime), Stamboll,

1911. Por autori, duke u ndalur edhe në bazat filozofike e sociale të mësimëve pedagogjike të Samiut, mes tjerash, thekson se, megjithëqë nuk ngriti ndonjë sistem filozofik dhe nuk shkroi vepra voluminoze filozofike, trajtoi probleme esenciale të filozofisë dhe shfaqti, më shumë se disa rilindës të tjerë, interesim edhe për mendime filozofike dhe çështje sociale, duke u ndalur në orientime filozofike progresive.

Si njohës i mirë i mendimit pedagogjik botëror, profesor Jashari nënvizon disa pedagogë evropianë, si: Pestaloci, Distevergu, Frebeli, Fridrih Dites etj., duke specifikuar mendimin pedagogjik për shkollën, edukatën, pedagogjinë, psikologjinë etj.

Duke parë edhe pamje filozofike të Samiut, apo të Naimit, dëshiroj të hap një vend reflektimi në formë paranteze, se në tekstet e filozofisë, për nxënësit tanë maturantë, përfshirë edhe botimin e vitit 2007, nuk ka as edhe një rresht për mendimin filozofik shqiptar, kur Pjetër Bogdani është doktor në filozofi dhe në teologji, për Sami Frashërin kemi veprën “Mendimi iluminist i Sami Frashërit”, për Hasan Tahsinin etj. Autorët e teksteve tona duhet të studiojnë veprat e autorëve tanë, pasi, kur i mohojmë vetë ne, kush do t’i afirmojë si vlerat tona?! Pra, mohojmë vetveten në tekstet tona të filozofisë, me të cilat po rritet brezi i ri.

Pjesa e tretë e veprës i kushtohet “Veprimtarisë arsimore dhe mendimit pedagogjik të Sami Frashërit”. Në këtë pjesë fillohet me “Sami Frashëri pedagog, dijetar i madh dhe personalitet i shquar i Rilindjes Kombëtare Shqiptare dhe i lëvizjes demokratike turke”.

Duke iu referuar veprës së njohur të Sami Frashërit, për të djeshmen, të sotmen dhe të ardhmen e Shqipërisë, autori shkruan:

“Kjo vepër meriton një shqyrtim serioz dhe të veçantë nga shumë aspekte, një ndër të cilët është edhe aspekti pedagogjik. Kjo vepër kryesore paraqet shkallën më të lartë të zhvillimit të kulturës dhe të inteligjencës shqiptare në periudhën e Rilindjes”.

Vlerësohen edhe librat shkollorë të Samiut, si në gjuhën shqipe, ashtu edhe në turqisht e arabisht, duke e pasuruar didaktikën dhe metodikën e gjuhës shqipe e të gjuhës arabe, metodikën e gjeografisë e të historisë etj. Autori shkruan edhe për aktivizimin e Samiut në tekstet shkollorë të abetares, gramatikës së gjuhës

shqipe, gjeografisë e historisë, si parakushte për hapjen e shkollave shqipe.

Në vepër jepen të dhëna të hollësishme për veprimtarinë e Samiut në hartimin e fjalorëve si dhe në fushën e periodikut.

Vepra enciklopedike Kamÿsu 1- A l m, e  oi p rpara mendimin kulturor n  Turqi. N  k t  vep r t  gjer  e me shum  vlera, duke trajtuar dijetar  dhe vepra t  disa filozof ve, si: Sokratin, Platonin, Erasmos, Rab len , Luterin, Lokun, Ovenin, Volterin etj., nuk l  pa trajtuar edhe konceptet pedagogjike t  tyre, duke mbajtur edhe q ndrim, si  b n me Rusoin, q  e  mon p r edukat n, por nj koh sisht e kritikon p r dogmatizmin e tij, largimin e f mij ve prej rrethit etj. Pra, autori sjell shum  t  dh na dhe nxjerr p rfundime mbi ndihmes n e Samiut n  zhvillimin e nj  pedagogjie t  re humaniste e shkencore.

Vepra n  fjal , pasi p rfshin edhe t  dh na mbi jet n e Samiut, trajton mjaft konkretisht edhe p rkrahjen e interpretimet e mendimeve pedagogjike t  Sami Frash rit.

N  kapituj t  ve ant  trajtohen parimet pedagogjike n  vepr n e Sami Frash rit, t  cilat nuk jan  krejt sisht si parimet e sotme didaktike, por jan  shum  interesante p r koh n, pasi p rfshijn : shqyrtimin historik t  pedagogjis , parimin e komb sis  dhe t  arsimit n  gjuh n amtare, parimin e demokratizimit, t  patriotizmit, t  karakterit shkencor, t  v llaz rimit, humanitetit, aktivitetit etj.

N  nj  kapitull m  vete trajtohen “Q llimi dhe detyrat e edukat s”, duke iu referuar fjal s s  Samiut:

*“Ajo q  qeveris bot n, nuk  sht  as forca, as ligji, por  sht  mir sjellja dhe edukata”.*

K tu zb rthehen vizionet mbi edukimin, si: detyrat e edukat s, edukata fizike, intelektuale, morale etj.

N  kreun XIV trajtohet pjes risht dhe n  m nyr  t  argumentuar “Ndikimi dhe vlera pedagogjike e vepr s s  Samiut”, duke e mbyllur edhe kapitullin XV me ve orit  thelb sore dhe r nd sin  e vepr s s  Sami Frash rit.

E mbyllur me nj  pjes  p rkufizimesh, si vep r,  ka  sht  realizuar edhe n  fund t  kapitujve, vepra vazhdon me literatur n e p rzgjedhur, me 12 faqe, vazhdohet me “regjistrin e emrave”, me nj  fjalorth, duke u plot suar dhe me “kontribute” t  autorit, me ilustrime t  drejtp rdrejta t  bashk koh sve, foto etj.

Prof.dr. Hajrullah Koliqi, në veprën e tij “Historia e arsimit dhe e mendimit pedagogjik shqiptar”, Prishtinë, 2002, pasi thekson se Jashar Rexhepagiqi ka kryer një varg detyrash të rëndësishme në fushën e arsimit e të pedagogjisë, se ka publikuar më shumë se 350 punime shkencore dhe profesionale, rreth 20 libra dhe studime të veçanta, shumë punime monografike, tekste shkollore, artikuj, vështrime kritike etj., nga fusha të ndryshme pedagogjike, përfundon:

*“Jashar Rexhepagiqi është pedagog i pedagogëve kosovarë, themelues i shkencës së pedagogjisë në Kosovë dhe një ndër studiuesit më të shquar të historisë së arsimit dhe të mendimit pedagogjik shqiptar”.*

Nuk kam çfarë t’i komentoj profesor Koliqit, veçse rreshtit të parë: “Jashar Rexhepagiqi është pedagog i pedagogëve mbarëshqiptarë...”.